

RAPORTI I NDËRMJETËM I ECURISË NËNTOR-DHJETOR 2021

PERMBAJTJA

- ▶ Informim mbi procesin zgjedhor, përbërjen e KD dhe ecurinë e procesit të regjistrimit në Gjykatën e OJF
 - ▶ Informim mbi Vendimmarrjet e KD
 - ▶ Perberja e Komiteteve
 - ▶ Informim mbi proceset gjyqesore
 - ▶ Kualifikimi i vijueshëm i Anetareve të IEKA për vitin 2021 dhe trajnimi i kandidatëve për Auditues Ligjor
 - ▶ Sfidat dhe Objektivat e KD përgjatë 12 mujorit të ardhshëm
 - ▶ Problematikat e hasura deri në Dhjetor 2021
 - ▶ Struktura Ekzekutive Dhjetor 2021
 - ▶ Aktivitete Nëntor-Dhjetor 2021
- 

Informim mbi procesin zgjedhor, përbërjen e KD dhe ecurinë e procesit të regjistrimit në Gjykatën e OJF

- **IEKA** organizoi **Mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme te Anetareve** te mbajtur ne datën **15 Tetor 2021** në orën 10:30, pranë ambjenteve te pallatit të Kongreseve, sipas njoftimit te Zotit Berti Pashko, Nr.324 Prot date 17.09.2021 “Ne lidhje me rendin e dites dhe shtyrjen e dates se zhvillimit te Mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme”.
- Numri i anetareve pjesëmarrës ne kete mbledhje ishte **178**, dhe numri i anetareve qe mungonin ishte 61, duke bere te mundur arritjen e kuorimit te nevojshëm sipas kërkesave te Statutit per mbajtjen e kësaj Asambleje.

Informim mbi procesin zgjedhor, përbërjen e KD dhe ecurinë e procesit të regjistrimit në Gjykatën e OJF

Ne kete Mbledhje u votua sa vijon:

- Shkarkimi i Anëtareve te KD te pa-dorëhequr me 152 vota pro shkarkimit, 25 vota kundër shkarkimit, dhe 0 vota abstenim (177 flete votimi te vlefshme, 1 flete votimi e pavlefshme), në mbështetje dhe zbatim të Vendimit Nr.148, datë 15.10.2021, të Komisionit të Votimit dhe Numërimit dhe të Proces-Verbalit Nr.7, datë 15.10.2021, “Për administrimin e materialeve të votimit të tretë, nxjerrjen dhe shpalljen e rezultateve të votimit të tretë”;
- Shkarkimi i Anëtareve te KKB me 127 vota pro shkarkimit, 48 vota kundër shkarkimit dhe 2 vota abstenim (177 flete votimi te vlefshme, 1 flete votimi e pavlefshme), në mbështetje dhe zbatim të Vendimit Nr.149, datë 15.10.2021, të Komisionit të Votimit dhe Numërimit dhe të Proces-Verbalit Nr.7, datë 15.10.2021, “Për administrimin e materialeve të votimit të tretë, nxjerrjen dhe shpalljen e rezultateve të votimit të tretë”;

Informim mbi procesin zgjedhor, përbërjen e KD dhe ecurinë e procesit të regjistrimit në Gjykatën e OJF

Ne kete Mbledhje u votua sa vijon:

Zgjedhja e 7 anëtarëve të Këshillit Drejtues (174 flete votimi te vlefshme, 4 flete votimi te pavlefshme) në mbështetje dhe zbatim të Vendimit Nr.150, datë 15.10.2021, të Komisionit të Votimit dhe Numërimit dhe të Proces-Verbalit Nr.9, datë 15.10.2021, “Për administrimin e materialeve të votimit të tretë, nxjerrjen dhe shpalljen e rezultateve të votimit të tretë”, si vijon:

- **Berti Pashko;**
- **Shpresa Breçani;**
- **Esmeralda Balluku;**
- **Erjon Saraçi;**
- **Nuriona Bërdica;**
- **Edrian Meslani;**
- **Orjana Kalaja.**

Informim mbi procesin zgjedhor, përbërjen e KD dhe ecurinë e procesit të regjistrimit në Gjykatën e OJF

Më datë 01.11.2021, ora 11:00, në ambientet e IEKA-s, u zhvillua mbledhja e konstituimit të Këshillit Drejtues të IEKA-së. Pas konstituimit të Këshillit, në mbështetje dhe zbatim të statutit, u zhvillua dhe votimi për zgjedhjen e Kryetarit dhe Zv/Kryetarit, dhe mbas procesit të votimit rezultoi se:

- ❖ **Kryetar i Këshillit Drejtues u zgjodh Z. Berti Pashko** (me 5 vota pro dhe 2 kunder), dhe,
- ❖ **Zv./Kryetare e Këshillit Drejtues u zgjodh Zj. Shpresa Breçani** (me 5 vota pro dhe 2 kunder).

Procesi zgjedhor dhe mbledhja e konstituimit janë noterizuar dhe procesverbalet përkatëse, janë depozituar pranë Gjykes se Rrethit Gjyqesor Tirane me date 11 Nentor 2021. Seanca gjyqesore per depozitim e këtyre vendimeve pranë Gjykes se Rrethit Gjyqesor Tirane eshte njoftuar per tu mbajtur ne datën 13 Janar 2022.

Informim mbi Vendimmarrjet e KD

□ Mbledhja e KD e dates 9 Nentor 2021 ka vendosur sa vijon:

1. Jane shqyrtuar kandidaturat e paraqitura pranë IEKA per pozicionin vakant te Drejtorit Ekzekutiv. Jemi informuar se ne datën 4 Tetor 2021, KD i kaluar ka komanduar ne pozicionin e Drejtoreshes Ekzekutive Znj. Arminda Qylafku emerimi se cilës eshte bere me Vendimin numër 47, te KD dhe ne mbështetje te kërkesave te Nenit 28.3 te Statutit (me 6 vota pro dhe 1 kunder).
2. Jane krijuar dy komisione te perkoheshme ne mbështetje te Nenit 3.4 te Statutit, si edhe kërkesës se bere nga $\frac{1}{4}$ e anëtarësisë per Anetaret e Rinj te KD sipas Vendimit numër 48 te KD, sa vijon:
 - Komisioni mbi investigimin e financës me qellim përgatitjen e nje raporti transparence financiare te IEKA përgjatë vitit 2021;
 - Komision mbi investigimin e protokollit me qellim përgatitjen e nje raporti transparence informative te IEKA përgjatë vitit 2021.

Informim mbi Vendimmarrjet e KD

❑ **Mbledhja e KD e dates 16 Nentor 2021** ka vendosur sa vijon:

1. Ne mbështetje të kërkesave të rregullores së Edukimit dhe Kualifikimit të Vijueshem, është emëruar në cilësinë e Kryetares së KEKV Znj, Nuriona Sokoli (Berdica).

❑ **Mbledhja e KD e dates 19 Nentor 2021** ka vendosur sa vijon:

1. Miratimin e propozimit të KEKV për zhvillimin e kualifikimit të vijueshëm profesional për vitin 2021;
2. Shpalljen dhe njoftimin e anëtarësisë për aplikimin për vendet vakante për 3 Anetare të Komitetit të Kontrollit të Brendshëm;
3. Thirrjen e Mbledhjes së Asamblese së Zakonshme në datën 22 Dhjetor 2021 dhe vendosjen e rendit të ditës.

Informim mbi Vendimmarrjet e KD

□ **Mbledhja e KD e dates 6 Dhjetor 2021** me Vendimin numër 60, ka vendosur sa vijon:

1. Miratimin e ristrukturimit te Komiteteve Ristrukturimi i IEKA duke patur ne përbërje 7 Komitete me nga 5 Anetare secili, ku përbërja do te jete Kryetar nje Anetar i KD, anëtar nje anëtar i KD dhe tre anetare te tjerë;
2. Draft struktura per secilin komision do paraqitet per aprovim ne KD brenda 15 Janarit 2022;
3. Draft procedura per funksionimin, qëllimin dhe misionin e secilit komitet do te paraqitet per miratim ne KD brenda 31 Marsit 2022, e me pas do dërgohet per miratim pranë Anetaresise ne Mbledhjen e Asamblese e me pas pranë BMP.


Informim mbi Vendimmarrjet e KD

□ Mbledhja e KD e dates 17 Dhjetor 2021 ka vendosur sa vijon:

1. Miratimin Raportin e ecurisë se veprimtarisë se KD gjate muajve nëntor-dhjetor 2021;
2. Miratimin e Projekt - Buxhetit per vitin 2022.

Perberja e Komiteteve

- Komitetet, per tu strukturuar deri ne 3 mujorin e pare te 2022 pranë IEKA jane miratuar si vijon:



Informim mbi proceset gjyqesore

- ❑ Procesi zgjedhor dhe mbledhja e konstituimit janë noterizuar dhe procesverbalet përkatëse, janë depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me datë 11 Nëntor 2021. Seanca gjyqesore për depozitimin e këtyre vendimeve pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është njoftuar për tu mbajtur në datën 13 Janar 2022.
- ❑ Në datën 8 Nëntor 2021, pranë IEKA ka mbërritur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë flete thirrje në datën 10 Nëntor 2021, për çështjen gjyqesore me palë paditëse Z. Elton Tirana dhe të paditur IEKA. Në këtë padi është kërkuar:
 1. Pavlefshmeri absolute të vendimeve të IEKA për thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme të IEKA të datës 15 Tetor 2021, dhe vendimeve të marra gjatë kësaj mbledhjeje; dhe
 2. Marrjen e masës së sigurimit për pezullimin e regjistrimit të vendimeve të Asamblesë të datës 15 Tetor 2021.
- ❑ Në këto kushte 7 Anetaret e KD të zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme e Anetareve të IEKA në mbledhjen e datës 15 Tetor 2021, janë paraqitur në Gjykatën e rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 10 Nëntor 2021, 25 Nëntor 2021, dhe në datën 10 Dhjetor 2021. Në seancën e datës 10 Dhjetor 2021 është vendosur:
 1. Rrezimi i marrjes së masës së sigurimit për pezullimin e regjistrimit të vendimeve të Asamblesë të datës 15 Tetor 2021; dhe
 2. Vendosja e datës 24 Janar 2022 për shqyrtimin e pikës 1 të akt padisë.
- ❑ Në do ju mbajmë të informuar në mënyrë transparente për zhvillimet e ardhshme të këtij procesi gjyqësor apo dhe të tjera, për shkak të rëndësisë që ato kanë në reputacionin e IEKA, si edhe angazhimin tonë për të cuar përpara këto procese gjyqesore me të gjitha shkallët e drejtësisë.


Informim mbi proceset gjyqesore

- ❑ Pranë gjykates se rrethit Gjyqesor Tirane eshte regjistruar per gjykim ceshtja civile me Pale Paditese Znj. Eleonora Olli dhe te paditur IEKA, me objekt:
 - ❑ Konstatimin e Pavlefshmerise absolute te Vendimit te Keshillit Drejtues te IEKA Nr. Extra te dates 16.9.2020;
 - ❑ Konstatimin e pavlefshmerise absolute te Vendimit te Keshillit Drejtues te IEKA Nr. 48 te dates 9.10.2020;
 - ❑ Marrjen e mases se sigurise per Vendimin e Keshillit Drejtues te IEKA Nr. Extra te dates 16.9.2020 dhe Vendimit te Keshillit Drejtues te IEKA Nr. 48 te dates 9.10.2020.
- ❑ Ky gjykim eshte pezulluar me kerkese te vete pales paditese Znj. Eleonora Olli. Pra gjykata ende nuk eshte shprehur me vendim per kete ceshtje per shkak te ketij pezullimi.
- ❑ Autoriteti i Konkurences eshte duke kryer nje hetim/monitorim administrative ne lidhje me tarifat e Audituesve Ligjore dhe deri tani nuk ka ndonje vendim nga ana e tij. IEKA eshte paraqitur ne nje séance degjimore per te dhene vleresimin e saj, por deri tani nuk ka ndonje konflikt gjyqesor me Autoritetin e Konkurences.
- ❑ Ne do ju mbajmë te informuar ne menyre transparente per zhvillimet e ardhshme te këtij procesi gjyqësor apo dhe te tjera, per shkak te rëndësisë qe ato kane ne reputacionin e IEKA, si edhe angazhimin tone per te cuar përpara këto procese gjyqesore me te gjitha shkallet e drejtësisë.

Kualifikimi i vijueshëm i Anetareve të IEKA për vitin 2021 dhe trajnimi i kandidatëve për Auditues Ligjor

- ❑ Përgjatë datave 9-21 dhjetor 2021, është zhvilluar trajnimi vjetor i detyrueshëm i Anetaresëve me 40 ore sipas kërkesave të Ligjit Mbi Auditimin, sipas programit të miratuar me vendimin numër 56 të datës 6 Dhjetor 2021 të KD.
- ❑ Po ashtu ka rifilluar funksionimi i KEKV, duke vënë në funksionim edhe planin e trajnimeve të stazhiereve duke përfshirë testimin e tyre. Detyrimet që duhen përmbushur deri më 31 dhjetor 2021 janë si vijon:

Kualifikimi i vijueshëm i Anetareve të IEKA për vitin 2021 dhe trajnimi i kandidatëve për Auditues Ligjor



Sfidat dhe Objektivat e KD përgjatë 12 mujorit te ardhshem

□ KD eshte i angazhuar maksimalisht per te vene ne funksionim te plote IEKA me synim arritjen e objektiveve si vijon:

- Politikat e transparences dhe konsultimi me anetaret e IEKA;
- Transparenca e aktiviteve te IEKA;
- Standartizimi i Auditimit;
- Bashkepunim me institucione të tjera për zhvillimin e profesionit.

Transparenca e aktiviteteve te IEKA

□ KD eshte i angazhuar maksimalisht per sa vijon:

- Të publikohen të gjitha vendimet e Këshillit Drejtues në faqen e internetit, ku anëtarët mund të kenë akses dhe të konsultohen në kohë reale;
- Të konsultohen periodikisht anëtarët për vlerësimin e aktiviteteve të Këshillit Drejtues në mënyrë që të përfshihen në aktivitetet institucionale;
- Gjithëpërfshirja e Anëtarëve të IEKA në komisione dhe projekte që do ndërmerren nga IEKA;
- Plotësimi dhe publikimi i strukturave drejtuese të IEKA.

Konsultimi me anetaret e IEKA

□ KD është i angazhuar maksimalisht për sa vijon:

- Te rishikohet Statuti i IEKA dhe t'i propozohen Asamblesë ndryshimet;
- Investigimi i plotë dhe analitik i aktiviteteve të IEKA si në terma organizativë ashtu edhe financiarë;
- Rishikimi i tarifës së Auditimit Ligjor dhe orëve të punës;
- Te krijohen mjetet për të ndihmuar Anëtarësinë në realizimin e transparencës në kuader të misionëve me interes për publikun.

Standartizimi i Auditimit

□ KD është i angazhuar maksimalisht për sa vijon:

❖ **Standartizimi i Auditimit nëpërmjet:**


- politikash mbështetje dhe zhvillimi për kolegët e rinj,
- hartimi i një metodologjie auditimi,
- fletet e punës të standardizuara apo software,
- rishikimi i tarifës së Auditimit Ligjor dhe orëve të punës;
- përditesimi i Kodit të Etikës dhe standardeve profesionale dhe
- zhvillimi i trajnimeve të diversifikuara sipas nevojave dhe eksperiencës;

Bashkepunim me institucione të tjera për zhvillimin e profesionit


□ KD është i angazhuar maksimalisht për sa vijon:

- Bashkëpunim institucional dhe funksional me BMP, me qëllim edhe marrjen e delegimit të funksionit të kontrollit të cilësisë për Njësitë jo me Interes Publik si edhe ngritja e kapaciteteve të duhura të IEKA për realizimin e këtij funksioni;
- Bashkëpunim institucional me Ministrinë e Financave dhe organeve të tjera shtetërore për rishikimi e kriterëve të klasifikimit të Njesive Ekonomike dhe ceshtje të tjera në interes të forcimit të rolit të Audituesit Ligjor;
- Bashkëpunim institucional me Keshillin Kombëtar të Kontabilitetit.

Sfidat dhe Objektivat e KD përgjatë 12 mujorit te ardhshem



Problematikat e hasura deri ne Dhjetor 2021



Struktura Ekzekutive Dhjetor 2021


□ Struktura aktuale e personelit ekzekutiv përbëhet nga:

1. Arminda Qylafku, Drejtor Ekzekutiv
2. Silvi Buzi, Specialist Edukimi
3. Klementina Kuqja, Specialist Edukimi dhe Finance
Kontabiliteti
4. Kejsi Cela, Sekretaria, Protokoll
5. Albana Pllaha, Detyra e mirëmbajtjes (pastrimit) të
ambjenteve

□ Gjatë vitit 2021 janë larguar nga puna me dëshirën e tyre punonjësit Tedi Ziko, Eniela Agolli, Sara Shurdhi Eralda Kullolli.

Organigrama

Buxheti i vitit 2022 eshte bazuar ne organigramen e meposhtme, propozuar nga stafi ekzekutiv, e cila parashikohet te aprovohet ne mbledhjen e pare te vitit 2022 te KD:



Stafi ekzekutiv parashikon qe sherbimet e teknologjise dhe ato juridike te mbeshteten ne kontrata sherbimi.

Aktivite Nentor-Dhjetor 2021

- Në datën 7 Dhjetor 2021 anetaret e KD morën pjesë pranë ambjenteve të Hotel Tirana International në tryezën e përbashkët të organizuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, me pjesëmarrës nga IKM, IEKA, BMP, Ministria e Financave, Tatimet, QKB etj. Temat e trajtuara ishin vështirësitë në raportimin financiar në kohë COVID si edhe problematikat nga procesi i fiskalizimit.
- Përfaqësuesit e IEKA diskutuan rreth problematikave në raportimin financiar në kohë COVID duke përfshirë ndikimin në vlerësimin e asetëve dhe të vazhdimësisë së biznesit, si edhe nevojën për koordinim midis kërkesave të Ligjit mbi Kontabilitetin 25/2018, dhe kufijtë e rinj që hyjnë në fuqi në vitin 2022 për klasifikimin e njësive ekonomike si të vogla, të mëdha ose të mesme dhe VKM 17 për kriteret e klasifikimit si NJIP.
- Në datën 20 Dhjetor 2021 u organizua darka e fundvitit me Anetaret e IEKA.



**Duke iu uruar te gjithë Anetareve te IEKA-s
Gezuar Festat, si dhe viti 2022 te jete vit i
mbare e i begate,**

Ju Faleminderit,